

Nr.: KSC-CC-2019-07

Vendos: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: **Mbrojtësi i Specializuar për z. Driton Lajçi**

Data: 9 dhjetor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës
referuese të z. Driton Lajçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese**

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësi i Specializuar për
z. Driton Lajçi
Z. Tobi Kadman

Hyrje

1. Më 2 dhjetor 2019, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi përgjigjen e saj ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së intervistës.
2. Parashtruesi dëshiron të bëjë këto parashtrime në kundërpërgjigje.
3. Historiku procedural i kësaj lënde është paraqitur në parashtrimet e mëparshme dhe rrjedhimisht nuk përsëritet në këtë parashtrim.

Përgjigjja e ZPS-së

4. Në thelb, përgjigjja e ZPS-së ('Përgjigjja'), e kundërshton kërkesën mbi bazën e dy arsyeve kryesore, gjegjësisht:
 - a) Kërkesa është në vetvete e papranueshme; dhe
 - b) Në qoftë se gjykohet e pranueshme, kërkesa është e pabazë.
5. Parashtruesi i kundërshton të dy pozicionet si tërësisht të pabaza dhe paraqet kundërpërgjigjen e mëposhtme.

Papranueshmëria

6. Për sa i takon papranueshmërisë ose jo të kërkesës referuese, ZPS-ja thekson këto argumente specifike:
 - a) Parashtruesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet e efektshme juridike në dispozicion;

- b) Parashtruesi nuk ka identifikuar vendimin përkatës ose dispozitën apo dispozitat kushtetuese që pretendohet se janë shkelur;
- c) Paneli kushtetues nuk ka juridiksion; dhe
- d) Parashtruesi nuk është i autorizuar të paraqesë kërkesë referuese.

Shterimi i mjeteve të disponueshme juridike

- 7. ZPS-ja pretendon se nuk janë shfrytëzuar 'të gjitha mjetet e disponueshme të përcaktuara prej ligjit',¹ dhe kjo rrjedhimisht e bën kërkesën e parashtruesit të papranueshme.
- 8. Parashtruesi kundërshton pretendimin e ZPS-së në paragrafët 13 dhe 14 të përgjigjes mbi bazën se, ndonëse pranohen kompetencat e përcaktuara në nenin 39 të Ligjit dhe në rregullën 48(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, baza e kundërshtimit të paraqitur nuk ka të bëjë me atë nëse fletëthirrja në vetvete ishte e paligjshme dhe, për këtë arsye, Prokurori nuk i është përgjigjur çështjes që po argumentohet.
- 9. Gjithashtu, si në shkëmbimet e saj me postë elektronike, po ashtu edhe gjatë intervistës, ZPS-ja konfirmoi se korniza ligjore e DHSK-së nuk përmban asnjë detyrim për dhënien e informacionit që po i kërkohet dhe se kundërshtimi ka të bëjë me rregullat dhe nëse korniza ligjore është e ligjshme duke pasur parasysh garancitë dhe detyrimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që ka DHSK-ja sipas Kushtetutës.

¹ Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese KSC-CC-2019-07/F00008 – paragrafi 10.

10. Rrjedhimisht, parashtrojmë me respekt se gjykatësi i procedurës paraprake, ose gjykatësi i vetëm, nuk ka kompetenca për të marrë vendim në lidhje me këtë kundërshtim të paraqitur.
11. Përkundrazi, neni 113(7) i Kushtetutës së Kosovës thotë:
“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”²
12. Argumenti i paraqitur nga parashtruesi është se atij po i shkelen të drejtat dhe, rrjedhimisht, instanca e përshtatshme me juridiksionin e duhur është Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe jo paneli i procedurës paraprake, i cili, parashtrojmë me respekt, nuk mund të marrë vendim për ligjshmërinë dhe/ose kushtetutshmërinë apo jo të pozicionit të ndërmarrë nga ZPS-ja.
13. Në paragrafin 13 të përgjigjes së saj, ZPS-ja duket se sugjeron që, me t’u bërë e qartë se nuk do të jepej asnjë informacion i mëtejshëm lidhur me pretendimin, domethënë lidhur me bazat e tij, ai do të ishte momenti kur duhet t’i paraqitet kërkesë panelit të procedurës paraprake ose gjykatësit të vetëm.³
14. Nga kjo rrjedh natyrshëm që duket se ZPS-ja sugjeron që do të kishte qenë e gatshme ta ndalonte intervistën në atë moment me qëllim që t’i bëhej parashtrim panelit të procedurës paraprake ose gjykatësit të vetëm.
15. Me gjithë respektin, ky është një pozicion krejtësisht jorealit, duke pasur parasysh që as në Ligj, as në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave nuk ka

² <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

³ Kjo mendohet të jetë faza e përshtatshme, duke pasur parasysh se data dhe ora e intervistës do të ishin mundësia e fundit kur ZPS-ja mund të jepte ndonjë informacion të kërkuar.

ndonjë dispozitë që e parashikon këtë. Megjithatë, në procesverbal është e shënuar që këto kërkesa u përsëritën në intervistë dhe u kërkua që intervista të shtyhej për një datë më të vonshme. Kjo u refuzua.

16. Rrjedhimisht, përkundër argumentit të paraqitur në paragrafin 15 të përgjigjes së ZPS-së, nuk mund të bëhet kërkesë për një urdhër/vendim të tillë përfundimtar.

Afatet kohore

17. Në paragrafin 12 të përgjigjes, sugjerohet se nuk është përmbushur kushti i paraparë në rregullën 20(1) të Rregullores së Punës që kërkesa referuese duhet të dorëzohet brenda dy (2) muajsh.
18. ZPS-ja nuk jep asnjë bazë për këtë parashtrim, përgjigjja thjesht deklaroi se [kushti] nuk është përmbushur. Parashtrajtje me respekt se ZPS-ja bën gabim të qartë faktik në lidhje me këtë pikë.
19. Sikurse thuhet edhe në paragrafin 4 të 'historikut procedural' të vetë ZPS-së, parashtruesi u mor në pyetje më 17 tetor 2019, ndërsa kërkesa referuese drejtuar Gjykatës Kushtetuese u dorëzua më 13 nëntor. Periudha e ndërmjetme kohore është pra, më pak se 1 muaj.
20. Pra [kërkesa] është plotësisht brenda afatit përkatës.
21. Edhe nëse si datë materiale merret data e lëshimit të fletëthirrjes, pra 25 shtatori 2019, afati do të përfundonte faktikisht më 25 nëntor 2019. Përsëri, ZPS-ja bën gabim faktik në parashtrimin e saj dhe rrjedhimisht përgjigjja e saj në lidhje me këtë pikë është krejtësisht e pabazë.

Themelësia e kërkesës referuese

22. Me gjithë respektin, ZPS-ja duket se ka bërë karakterizim të gabuar të asaj që argumenton parashtruesi.
23. Edhe në qoftë se pranojmë se, në parim, Ligji dhe Rregullorja e DHSK-së ofrojnë një kornizë ligjore e cila është në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën e zbatueshme për të drejtat e njeriut, parashtrojmë me respekt se çështja qëndron tek mënyra se si janë interpretuar këto detyrime sipas Ligjit dhe Rregullores. Me këtë mënyrë të vepruari ZPS-ja ka krijuar një situatë që konsiderohet e papajtueshme dhe, si rrjedhojë, thjesht të pohuarit se ligji dhe rregullorja janë të pajtueshme nuk mund të pengojë mbikëqyrjen gjyqësore dhe as nuk i përgjigjet pyetjes nëse veprimet e saj ishin në pajtueshmëri me këto parime themelore. Është krejt e qartë se këto garanci bazë qëndrojnë në themel të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe se një vlerësim i tillë kryhet nga gjykata.
24. Në kundërshtim me argumentin e ZPS-së në paragrafin 18 të përgjigjes, parashtrimi nuk i ngatërron të dy kategoritë dhe as nuk është *“pa asnjë bazë ligjore ose logjike”*.
25. Gjithashtu, në kundërshtim me argumentin e paraqitur në paragrafin 19 të përgjigjes së ZPS-së, nuk bëhet përpjekje që neni 6(3) të lexohet në tërësinë e tij brenda kontekstit të nenit 38 të ligjit; të sugjerosh diçka të tillë, me gjithë respektin, do të thotë ta shtrembërosh parashtrimin.
26. ZPS-ja duket sikur sugjeron së pari që neni 6 i Konventës ka vetëm vlerë të kufizuar për sa i përket procedurave paraprake dhe, më tej, në paragrafin 22, ZPS-ja sugjeron se nuk është paraqitur asnjë burim ligjor që do të mbështeste

pretendimin e ngritur nga parashtruesi dhe e hedh poshtë burimin e cituar si burim që nuk ka lidhje me çështjen.

27. Argumenti i thjeshtë që paraqet parashtruesi në këtë rast është se, për efekt të ligjit, ai është objekt i një 'akuze penale' sipas burimit ligjor të cituar.
28. Rrjedhimisht, ai ka të drejtën e garancive që i ofrohen dikujt që është objekt i një 'akuze penale', një ndër të cilat është vënia në dijeni për akuzën e veprës penale që dyshohet se ka kryer si edhe bazat dhe arsyet e asaj akuze.
29. Pranohet se ekziston një dallim midis fazave para dhe pas aktakuzës dhe, për rrjedhojë, edhe detyrimet që ka prokuroria dhe/ose organi hetimor janë të ndryshme. Megjithatë, ZPS-ja argumenton se duke qenë se ajo është në fazën e hetimeve, asnjë i dyshuar nuk ka të drejtën të vihet në dijeni për bazat e akuzës.
30. Kjo është pikërisht ajo që ne argumentojmë se është e papajtueshme.
31. Në asnjë fazë nuk është sugjeruar se duhet të bëhet e ditur çdo hollësi dhe, si rrjedhojë, edhe argumenti i paraqitur në paragrafin 25 të përgjigjes së ZPS-së është një karakterizim i shtrembëruar i kërkesës.
32. Në asnjë fazë nuk është sugjeruar se duhet të jepen të dhënat e dëshmitarëve dhe asnjëherë nuk është sugjeruar që të bëhen të ditura provat që mund të cenojnë kryerjen e hetimit.
33. Argumenti i thjeshtë është se, pa pasur njohuri për bazat dhe arsyet e akuzës kundër tij, parashtruesi nuk ishte në gjendje të merrte një vendim mbi bazën e informacionit në fazën e intervistës; po kështu as mbrojtësi i specializuar nuk ishte në gjendje t'i jepte parashtruesit këshillat e duhura ligjore.

34. Është pikërisht kjo që ne sugjerojmë se e bën procedurën e tanishme të papajtueshme dhe rrjedhimisht të paligjshme, sikurse theksohet në burimin ligjor të cituar, si edhe në Direktivën e BE-së të cilën ZPS-ja thotë se nuk duhet të merret parasysh sepse, *“nuk është pjesë e kornizës ligjore të zbatueshme të Dhomave të Specializuara”*. ZPS-ja nuk mund të zgjedhë të marrë vetëm ato që pëlqen nga legjislacioni, direktivat dhe konventat. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk është pjesë e kornizës ligjore, megjithatë ZPS-ja dhe DHSK-ja janë përsëri të detyruara ta zbatojnë atë.
35. Sidoqoftë, pavarësisht nga argumenti i paraqitur në paragrafin 24, interpretimi i ZPS-së, me gjithë respektin, është i pasaktë.
36. Në qoftë se ZPS-ja do t'i përmbahet qëndrimit se në asnjë fazë para intervistës nuk do të jepet asnjë bazë provuese, mund të argumentohet se vihet në pikëpyetje edhe e gjithë procedura e intervistimit të të dyshuarit.

Përfundim

37. Vlen të vihet në dukje se duket se ZPS-ja nuk u jep përgjigje elementëve materialë të kërkesës dhe, me qëllim apo pa dashje, i ka fryrë disi argumentet e paraqitura.
38. ZPS-ja duket se nuk e kundërshton përkufizimin e akuzës penale dhe as nuk i trajton elementët përkatës të 'Ligjit'; në vend të kësaj ajo parapëlqen të trajtojë masën në të cilën zbatohet neni 6(3) në fazën para apo gjatë intervistës.
39. Rrjedhimisht dhe për hir të qartësisë, sikurse është argumentuar në parashtrimet fillestare të parashtruesit, argumenti ynë është se, qëndrimi sipas të cilit të dyshuarit nuk i jepet asnjë informacion përpara intervistës, si

në rastin e parashtruesit, është antikushtetues, i paligjshëm dhe shkel ato norma të të drejtave të njeriut të cilat Kosova, dhe rrjedhimisht edhe DHSK-ja, ka detyrimin ligjor t'i zbatojë.

40. Pikënisja është se parashtruesi, ose çfarëdo individ, është objekt i një 'akuze penale' sipas *Ibrahim and others v. The UK*⁴. Duke u cilësuar si i dyshuar, parashtruesi konsiderohet se është i dyshuar lidhur me një akuzë penale.
41. Pas kësaj vijon çështja e dytë nëse pasi është përcaktuar se parashtruesi është objekt i një akuze penale, a zbatohen garancitë e nenit 6 të Konventës dhe garancitë që përmban Ligji dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Provave në fazën para aktakuzës dhe në fazën e hetimeve.
42. Kërkesa argumenton në favor të asaj se, në rast se një individ është objekt i një akuze penale, atij duhet t'i bëhet e ditur akuza si edhe baza e asaj akuze.
43. E pranojmë plotësisht se para dhe pas nxjerrjes së aktakuzës zbatohen detyrime ligjore të ndryshme dhe askund nuk është sugjeruar se duhet të bëhet e ditur tërësia e argumenteve dhe provave të prokurorisë në fazën e intervistës; të sugjerosh të kundërtën është, siç e kemi thënë më herët, shtrembërim i këtij qëndrimi.
44. Në nivel ndërkombëtar, shtete të shumta, ndër të cilat edhe Britania e Madhe, kanë kohë që e kanë pranuar procedurën për dhënien e informacionit para fillimit të intervistës, në mënyrë që personit të akuzuar t'i mundësohet të marrë vendim në bazë të informacionit dhe gjithashtu, që mbrojtësi, nëse është marrë një i tillë, t'i japë të dyshuarit këshillat e duhura.

⁴ [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-166680"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

45. Masa në të cilën bëhet kjo vënie në dijëni i lihet gjykimit të zyrtarit që kryen intervistën. Megjithatë, zbatimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse, sipas së cilës nuk do të jepet asnjë informacion në asnjë kohë, nuk është i përligjshëm dhe mund të argumentohet se është një kufizim i paligjshëm i ushtrimit të gjykimit të pavarur.
46. Si rrjedhojë, ne u qëndrojmë argumenteve të paraqitura në kërkesën fillestare, pra, që praktika se nuk është e nevojshme të jepet asnjë informacion është e paligjshme, e papajtueshme me normat dhe të drejtën përkatëse të të drejtave të njeriut, Kushtetutën, Ligjin, dhe Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

/nënshkrim/

Tobi Kadman

Mbrojtës i Specializuar për z. Driton Lajçi

Numri i fjalëve në origjinal: 1992

Tobi Kadman, pjesëmarrës

Mbrojtës i Specializuar për z. Driton Lajçi

27 nëntor 2019

Në Hagë, Holandë